



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:160826  
Datë: 22.11.2024  
Numri i dokumentit: 06494835

**C-III-17-0171**

22 nëntor 2024

**A (R)K** – Fshati C, Malishevë

*Kundër*

*Të Paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” Prishtinë.  
**Komuna e Malishevës** - Malishevë

Gjyqtarja e poshtëshënuar e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pas pranimit të lëndës nr. C-III-17-0171 merr këtë:

**AKTVENDIM**

Mbyllet lënda me numër C-III-17-0171, e regjistruar me 02.08.2017 dhe e njëjta bashkohet me lëndën **C-III-12-0415**, për procedim të mëtutjeshëm.

**A r s y e t i m**

Në lëndën C-III-17-0171, gjyqtari raportues ka planifikuar të pezulloj procedurën kundër NSh ( për shkak të inicimit të procedurës së likuidimit) dhe me i veçua procedurat kundër të paditurës së dytë – Komuna e Malishevës. Prandaj me anë të urdhrit të dt. 2 gusht 2017 është urdhëruar veçimi i lëndës. Lënda e vjetër e ka marrë një numër të ri të lëndës, ndërsa lënda e re ( e përbërë prej kopjes së njëjtë të dosjes origjinale) e ka marrë numrin e lëndës së vjetër. Pasi që asgjë nuk ka ndodhur, që nga ajo kohë të dyja shkresat e lëndëve kanë qenë identike.

Pra lëndët C-III-17-0171 dhe C-III-12-0415 do të bashkohen përsëri në një lëndë kundër të dy të paditurave, nën shkresat me numrin C-III-12-0415.

Andaj duke qenë se kemi të bëjmë me një ankesë të njëjtë e cila është e evidentuar në gjykatë me dy numra të ndryshëm atëherë në kuptim të nenit 41 të Ligjit të Dhomës së Posaçme dhe në kuptim të zgjedhjes më efektive të çështjes është bërë bashkimi i lëndëve dhe në vazhdim kjo çështje do të udhëhiqet sipas numrit C-III-12-0415 .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gj y q t a r e  
**Hajrie Shala**